



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:075237
Datë: 03.06.2024
Numri i dokumentit: 05768959

KE.nr. 378/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen juridike të paditësit- propozuesit të masës së sigurisë Universiteti “Ukshin Hoti” me seli në Prizren, kundër të paditurit – kundërshtarit të sigurimit D.P.H. “Studenti” – F.S.M. B.I. me nr. të biznesit 811004845 dhe me seli në Prizren, me objekt kontesti lirim i pronës dhe kompensim i qirasë, pas shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seancës, me datë 03.06.2024 morri këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm për të vendosur në çështjen juridike kontestimore në mes të paditësit- propozuesit të masës së sigurisë Universiteti “Ukshin Hoti” kundër të paditurit – kundërshtarit të sigurimit D.P.H. “Studenti” – F.S.M. B.I. me objekt kontesti lirim i pronës dhe kompensim i dëmit.
- II. Për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Paditësi Universiteti “Ukshin Hoti” me seli në Prizren, me datë 06.03.2024, pranë Gjykatës Themelore në Prizren ka paraqitur padi së bashku me propozim për caktimin e masës së sigurisë

kundër të paditurit D.P.H. “Studenti” – F.S.M. B.I. me nr. të biznesit 811004845, me objekt kontesti lirim i pronës dhe kompensim i borxhit.

Gjykata Themelore në Prizren, pas shqyrtimit paraprak të padisë, me aktvendimin C.nr. 1347/2024 të datës 12.03.2024, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore ashtu që lëndën e ka dërguar për vendosje për Gjykatën Komerciale të Kosovës.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente pikërisht Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, për arsyet si në vijim:

Kompetenca e kësaj gjykate është e rregulluar me nenin 13 par. 1.1 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale me të cilin përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*, lidhur me paragrafin 2 i cili përcakton se: *“Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.9 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Ekonomike”*.

Në kuptim të dispozitave të lartcekura, e duke marrë për bazë shkresat që gjenden në dosje të lëndës, gjykata gjeti se në rastin konkret kemi të bëjmë me një kontest i cili zhvillohet në mes të një personi juridik publik si paditës dhe një shoqërie tregtare si e paditur, ndërsa objekt kontesti paraqitet lirimi i pronës që buron nga një marrëdhënie juridiko-pronësore si dhe kërkesa për pagesën e qirasë së paluajtshmërisë. Nga këto të gjetura, gjykata vlerëson se kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është pikërisht Gjykata Themelore në Prizren kjo në mbështetje të nenit 41, par.1 të LPK-së me të cilin përcaktohet se *“Për gjykim në kontestet lidhur me pronësinë dhe të drejtat sendore të tjera mbi sendet e paluajtshme, në kontestet për shkak të pengim posedimit mbi sendin e paluajtshëm, si dhe në kontestet nga raportet e qiradhënies së paluajtshmërisë, ose nga kontratat për shfrytëzimin e banesave apo të lokaleve të punës, është ekskluzivisht kompetente gjykata në territorin e të cilës ndodhet paluajtshmëria”*, kjo sepse në rastin konkret, kontesti paraqitet lidhur me të drejtat tjera sendore mbi sendet e paluajtshme, pasi

që si kërkesë kryesore në padi paraqitet lirimi i pronës së paluajtshme të dhënë me qira nga paditësja për të paditurën, pronë kjo që shtrihet në territorin e Komunës së Prizrenit.

Gjykata sqaron se me nenin 13. par.1, nën par. 1.7. të Ligjit për Gjykatën Komerciale (Ligji nr. 08/L-15) përcaktohet se Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar ndër tjerash edhe për *“kontestet në mes shoqërive tregtare lidhur me të drejtat sendore, siç është e paraparë me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare”*, konteste këto të cilat në kuptim të par. 3 të këtij neni trajtohen nga Departamenti i Përgjithshëm i kësaj gjykate. Por në kuptim të kësaj dispozite, kusht që një kontest i natyrës pronësore të trajtohet pranë Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Komerciale të Kosovës është që ky kontest të zhvillohet në mes dy shoqërive tregtare, situatë kjo që nuk rezulton të jetë në rastin konkret, pasi siç u elaborua më lartë, në cilësi të paditësit paraqitet personi juridik publik, konkretisht Universiteti “Ukshin Hoti” me seli në Prizren.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 dhe 19 lidhur me nenin 387.1 pika (u) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 378/24, datë 03.06.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.